



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
REKTORI

Nr. 1924/Prot.  
1

Tiranë, 30.06. 2020

**URDHËR**

**Nr. 6 , datë 30.06.2020**

***“PËR SHPALLJEN E DITËS SË FILLIMIT TË PROCESIT ZGJEDHOR DHE DATËN E PËRCAKTUAR NGA MINISTRI I ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË, PËR ZGJEDHJEN E AUTORITETEVE DREJTUESE DHE SENATIN AKADEMIK TË UT”***

Në zbatim të nenit 39 të ligjit nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenit 5, pika 3 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës”, të miratuar me Vendimin nr.5 datë 10.02.2020 të Senatit Akademik të UT, dhe në Urdhërin nr.175 datë 30.06.2020, të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për zhvillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë”, në cilësinë e autoritetit më të lartë drejtues në Universitetin e Tiranës,

**URDHËROJ:**

1. Dita e fillimit të procesit zgjedhor për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës, **është data 30 Qershor 2020.**
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës, **është data 30 Korrik 2020.**
3. Ky Urdhër i përcillet për njohje dhe zbatim, të gjitha njësive kryesore dhe njësive të tjera në përbërje të Universitetit të Tiranës.
4. Ky Urdhër do të shpallet në mënyrë të menjëhershme në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës dhe në faqen zyrtare të çdo njësie kryesore dhe çdo njësie tjetër, në përbërje të Universitetit të Tiranës.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI  
**PROF.DR.MYNYR KONI**

